

VENDIM
Nr. 2, datë 28.1.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 5, DATË 22.2.2023, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË SHA”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 28.1.2026, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 5, datë 22.2.2023, ‘Për licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.’””,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. 1069 prot., datë 21.1.2026, me lëndë: “Njoftim mbi ndryshimin e drejtuesit ligjor dhe një nga drejtuesit teknik të Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe një nga drejtuesit teknik të shoqërisë të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, të ndryshuar. Me postë elektronike, datë 21.1.2026 dhe 23.1.2026, ka bërë plotësimet përkatëse.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a. për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, të ndryshuar.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a., me vendimin nr. 5, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e ujërave të ndotura.

4. Drejtues ligjor i Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a., z. Flauers Shoshi, është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Hidroteknikë, në vitin 2005.

5. Drejtues teknik i shoqërisë z. Erald Bali, me titull Inxhinier Elektrik, është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, dega Elektrike, në vitin 2011, dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

6. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a., të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958, dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a. është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Pikat 2 a) dhe 2 b) të vendimit të KKRR-së nr. 5, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a.” ndryshojnë, si më poshtë:

“a) Drejtues ligjor: z. Flauers Shoshi;

b) Drejtues teknik: z. Erald Bali.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gerta Lubonja